



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 107/6 Prot.

Tiranë, më 16.04.2021

V E N D I M

Nr.44, datë 16.04.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë të vendimit nr.2 dt. 02.02.2021 të Departamentit të Administratës Publike, për anulimin e procedurës së konkurrimit për grupin e pozicioneve me kod #3400, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Tatimeve Indirekte”, në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal, të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a.

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë të anulimit e procedurës së konkurrimit me kod #3400,

Vërej se:

Shtetësja *****, nëpërmjet dy kërkesave të regjistruara me nr.107 prot., datë 01.02.2021 dhe nr. 107/2 prot., datë 16.02.2021 “Kërkesë/ankesë në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë e ulët drejtuese”, ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele, për grupin e pozicioneve me kod # 3400, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Tatimeve Indirekte”, në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal, të Drejtorisë së Përgjithshme

të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezulton e vërtetuar se: shtetasja *****, ka aplikuar në faqen zyrtare të DAP, në procedurën e lëvizjes paralele, me kod # **3400**, për pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Tatimeve Indirekte*”, në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal, të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Pas dorëzimit të dokumentacionit përkatës, ankuesja, sipas parashikimeve të dispozitave ligjore në fuqi, në datën 30.12.2020, është njoftuar se është kualifikuar në fazën e parë të konkurrimit dhe se në datën 11.01.2021, do të zhvillohej intervista me gojë, veprime të cilat konkurrentja i ka konsideruar të mirëqena.

Në datën 11.01.2021, ankuesja është paraqitur pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku është zhvilluar intervista me gojë, në prani të dy anëtarëve përfaqësues të Ministrisë dhe një përfaqësuesi nga Departamenti i Administratës Publike, por në përfundim, nuk është shpallur rezultati.

Më pas, nëpërmjet shkresës nr. 209/2, datë 05.02.2021, ajo njihet me përmbajtjen e vendimit nr. 2, datë 02.02.2021, të Departamentit të Administratës Publike, mbi anulimin e kësaj procedure konkurrimi, me arsyetimin se mbi bazën e një ankese anonime të paraqitur në datën 11.01.2021, kishte nisur një hetim administrativ, mbi rregullshmërinë e përbërjes së Komitetit të Pranimit për Lëvizje Paralele (KPLP).

Në lidhje me sa më sipër, ankuesja pretendon se në këtë rast nuk është zbatuar pika 26, e Kreut II, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, nëpërmjet lëvizjes paralele, pasi Komiteti i Pranimit për Lëvizje Paralele, nuk ka njoftuar njësinë përgjegjëse, Departamentin e Administratës Publike, në lidhje me rezultatet e testimit me gojë dhe nga ana tjetër, ky i fundit nuk ka kryer veprimet për njoftimin e rezultateve të testimit me gojë, për procedurën e lëvizjes paralele, për grupin e pozicioneve me kod # **3400**, për pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Tatimeve Indirekte*”, në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal, të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ankuesja ngre pretendimin gjithashtu se, vendimi nr. 2, datë 02.02.2021, i Departamentit të Administratës Publike, për anulimin e procedurës së konkurrimit, për grupin e pozicioneve me kod # **3400**, i është komunikuar në datën 12.02.2021, vonesë e cila është bërë shkak për paraqitjen prej saj të disa ankesave pranë njësisë përgjegjëse (DAP), në mënyrë elektronike si dhe një kërkesë me shkrim, me nr. 1065, datë 11.02.202, për të cilat nuk ka marrë ende asnjë përgjigje.

Gjithashtu, ankuesja pretendon se, në lidhje me këtë hetim administrativ njësia përgjegjëse (DAP), duhet të kishte vënë në dijeni këtë shtetase si palë e përfshirë në këtë procedurë administrative, sikurse parashikohet në pikën 1, të nenit 42 të Kodit të Procedurës Administrative, i cili përcakton se: *(Në rastet kur procedura administrative fillohet nga organi publik, ky i fundit njofton të gjitha palët në proces për fillim e veprimeve).*

Për këtë rast ajo shprehet se, është shkelur parimi i transparencës i parashikuar në nenin 5, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: *“Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të”*. Lidhur me këtë situatë ajo pretendon se janë shkelur dhe parimet e lirisë së informacionit, ç’ka ka sjellë si pasojë mohimin e të drejtës për të marrë pjesë dhe për të paraqitur shpjegimet, faktet dhe provat nga ana e ankueses ******, për zgjidhjen e këtij hetimi administrativ nga ana e DAP.

Për efekt të vlerësimit të pretendimeve të kësaj konkurrenteje dhe veprimeve të kryera nga njësia përgjegjëse dhe Komiteti i Pranimit për Lëvizje Paralele, nëpërmjet shkresës nr. 107/1 prot., datë 15.02.2021, *“Kërkim dokumentacioni për verifikimin e kërkesës së konkurrentes Valbona Sako, në lidhje me zhvillimin e procedurës së konkurrimit me kod #3400”*, është kërkuar nga Departamenti i Administratës Publike, një kopje e akteve të procesit të seleksionimit, konkurrimit dhe anulimit të procedurës së pranimit në shërbimin civil, nëpërmjet lëvizjes paralele, për grupin e pozicioneve me kod # **3400**, për pozicionin e punës *“Përgjegjës i Sektorit të Tatimeve Indirekte”*, në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal, të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 1170 prot., datë 19.02.2021, *“Kthim përgjigje”*, ka vënë në dispozicion gjithë praktikën e kërkuar nga Komisioneri për kryerjen e procedurës së konkurrimit të mësipërm si dhe veprimeve administrative të kryera.

Në përfundim të analizës së dokumentacionit të mësipërm, vënë në dispozicion nga Departamenti i Administratës Publike dhe dokumentacionit që shoqëron kërkesën e paraqitur, rezulton se njësia përgjegjëse, në kuadër të realizimit të planit vjetor të rekrutimit për vitin 2020, si dhe në zbatim të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, ka publikuar në faqen zyrtare të tij, ndër të tjera edhe procedurën e lëvizjes paralele, për grupin e pozicioneve me kod # **3400**, për pozicionin e punës *“Përgjegjës i Sektorit të Tatimeve Indirekte”*, në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal, të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Sipas shpjegimeve të njësisë përgjegjëse, ankuesja rezulton të ketë qenë e vetmja kandidatë që ka aplikuar për pozicionin e mësipërm.

Pasi janë kryer disa veprime administrative si, seleksionimi paraprak, shqyrtimi dhe vlerësimi i dosjes personale të konkurrentes dhe intervista me gojë nga ana e Komitetit të Pranimit për Lëvizjen Paralele, pranë Departamentit të Administratës Publike, është depozituar

kërkesë/ankesa, nr.209 prot., datë 11.01.2021, në të cilën ngrihet pretendimi se, përbërja e Komitetit të Pranimit për Lëvizje Paralele (KPLP), për këtë procedurë konkurrimi nuk ka qenë e rregullt, duke cënuar në këtë mënyrë meritokracinë në procedurat administrative të rekrutimit dhe favorizuar konkurrentë të caktuar.

Duke marrë shkas nga kjo ankesë dhe rrethanat e parashtruara në të, Departamenti i Administratës Publike, bazuar në nenet 5,7 pika 3, dhe 20, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe nenet 41, pika 1, gërma “b”, 77,79, pika 1 dhe 81, të ligjit nr. 44/2015 “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ka vendosur nisjen e një hetimi administrativ, për të vlerësuar ligjshmërinë e përbërjes së KPLP.

Gjatë këtij hetimi administrativ është evidentuar që, në pikën 16, të Kreut II, të vendimit nr.242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, parashikohet se, Komiteti i Përhershëm i Pranimit për Lëvizjen Paralele (KPLP), ka në përbërje tre anëtar, si më poshtë:

- a) *1 (një) përfaqësues nga institucioni për të cilin është shpallur vendi vakant, i të njëjtit nivel ose i një niveli më të lartë se pozicioni që rekrutohet, kur është i mundur, i caktuar nga DAP;*
- b) *Eprori direkt;*
- c) *1 (një) përfaqësues nga DAP-i për institucionet e administratës shtetërore. Në rastin e institucioneve të pavarura dhe njësisve të qeverisjes vendore, anëtari i tretë emërohet nga titullari i institucionit, midis nëpunësve civilë të institucionit, të nivelit të mesëm drejtues, nëse është e mundur.*

Në praktikën e materialeve të dërguara nga institucioni rezulton se, sipas Urdhrit nr. 5 prot., datë 08.01.2021, Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele (KPLP), në procedurën me kod # **3400**, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Tatimeve Indirekte”, në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal, të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a, ka patur përbërjen si më poshtë:

1. *Anëtar- *****, përfaqësues i Departamentit të Administratës Publike;*
2. *Anëtar- *****, përfaqësues i Institucionit, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Analizave dhe Statistikave, në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;*
3. *Eprori Direkt (autorizuar) - *****, me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.*

Referuar parashikimeve të sipër përmendura, të Kreut II, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme

drejtuese”, i ndryshuar, si edhe përbërjes konkrete të këtij komisioni rezulton se, anëtarët e komitetit të përzgjedhur nga ana e institucionit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk janë nëpunësit e përcaktuar nga ky akt nënligjor.

Sipas strukturës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratuar me Urdhrin nr. 89, datë 13.06.2018, të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*” i ndryshuar, rezulton se pozicioni i shpallur i punës në cilësinë e eprorit direkt, është Drejtori i Drejtorisë së Harmonizimit Fiskal, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe jo Drejtori i Drejtorisë së Avokatit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, siç në fakt ka marrë pjesë në përbërjen e KPLP.

Ky përfundim arrihet për shkak se, sipas përcaktimit të pikës 1, gërma “e”, të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, parashikohet se:

“Epror direkt” është:

- i) Titullari i institucionit për nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtues, përfshirë nëpunëtit në pozicionet e koordinatorit të posaçëm dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë;*
- ii) Sekretari i Përgjithshëm apo nëpunësi në pozicion ekuivalent me të, për drejtorinë drejtorive dhe drejtuesit e degëve territoriale të institucionit;*
- iii) Titullari i institucionit të varësisë për drejtorët brenda këtij institucioni;*
- iv) Drejtori i Drejtorisë për të gjithë nëpunësit e pozicioneve të tjera.*

Në rastin konkret, Departamenti i Administratës Publike pohon faktin se, nga të dhënat që administrojnë ky institucion, pozicioni i punës Drejtor i Drejtorisë së Harmonizimit Fiskal, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, aktualisht nuk është pozicion vakant dhe në bazë të pikës 17, të Kreut II, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar “*Anëtarët, të caktuar sipas pikës 16, të Kreut II, të këtij vendimi, me përjashtim të rasteve të pengesave ligjore, janë të detyruar të marrin pjesë në Komitetin e Pranimit për Lëvizje Paralele, ku janë caktuar*”.

Nga verifikimi i të dhënave të Regjistrimit Qendror të Personelit (*krijuar në bazë të vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit”, i ndryshuar*), pozicioni i punës Drejtor i Drejtorisë së Harmonizimit Fiskal, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, është i plotësuar me nëpunësin përkatës.

Në rastin konkret nuk ka patur ndonjë pengesë ligjore për pjesëmarrjen në përbërjen e KPLP, të eprorit direkt Drejtorit të Drejtorisë së Harmonizimit Fiskal, në Drejtorinë e Përgjithshme të

Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në këtë konkurrim. Pengesë ligjore, që mund të justifikonte mospjesëmarrjen dhe zëvendësimin e tij me një nëpunës tjetër, bazuar në përmbajtjen e nenit 30, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, do të përbënte vetëm ekzistenca e ndonjë prej shkaqeve që përmenden në mënyrë të shprehur në këtë dispozitë dhe jo çdo rrethanë që mund të vlerësohet në mënyrë subjektive, nga drejtuesi i institucionit që ka pozicionin e lirë, njësia përgjegjëse, etj.

Përbërja e mirëpërcaktuar në dispozitat e sipërpërmendura e Komitetit të Pranimit për Lëvizje Paralele, lidhet me të drejtën prekluzive të tij, për të bërë vlerësimin dhe shpalljen e fituesit/fituesve të procedurës së konkurrimit për lëvizjen paralele për kategorinë e ulët drejtuese, ndërsa njësia përgjegjëse (DAP), emëron fituesin mbi bazën e vlerësimit të këtij Komiteti. Kjo kompetencë e rëndësishme e këtij organizmi, përcakton edhe rëndësinë e përbërjes korrekte të Komitetit pasi në të kundërtën procedura e rekrutimit do të rezultojë e organizuar në mosrespektim të dispozitave procedurale dhe materiale, gjë e cila ndikon dhe në drejtësinë e ligjshmërinë e veprimeve të kryera dhe vendimeve të marra.

Nga gjithë sa më sipër arrihet në përfundimin se zëvendësimi i eprorit direkt, pa ekzistencën e ndonjë pengese ligjore, me një nëpunës tjetër qoftë me të njejtën kategori, është një shkëlqje e cila cenon rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e procesit të rekrutimit të kryer për lëvizje paralele, për grupin e pozicioneve me kod # 3400, në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Tatimeve Indirekte, në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale”, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për rrjedhojë, vendimmarrja e Komitetit të Pranimit për Lëvizje Paralele, në rastin konkret është e cënuar në thelb, pasi ky komitet, për shkak të përbërjes jo të rregullt, nuk mund të jetë kompetent të kryejë procesin e rekrutimit në këtë rast.

Departamenti i Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse, duke patur parasysh rregullat e përcaktuara në dispozitat e sipërpërmendura, me të drejtë, me vendimin nr. 2, datë 02.02.2021, ka vendosur anulimin e Urdhrit nr. 5 prot., datë 08.01.2021, për krijimin e Komitetit të Pranimit për Lëvizjen Paralele (KPLP), për zhvillimin e konkurrimit me kod # 3400, për procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë e ulët drejtuese, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Tatimeve Indirekte, në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale”, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a, duke urdhëruar përsëritjen e tij brenda një afati të arsyeshëm.

Nga sa u parashtrua më sipër dhe nga analiza në tërësi e dokumentacionit të administruar arrihet në përfundimin se, veprimet e njësisë përgjegjëse janë kryer në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikën 1, gërma “e”, të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe pikës 16 të Kreut II të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit nr.2, datë 02.02.2021 të Departamentit të Administratës Publike, me të cilin ka vendosur anulimin e Urdhrit nr. 5 prot., datë 08.01.2021, për krijimin e Komitetit të Pranimit për Lëvizjen Paralele (KPLP), për zhvillimin e konkurrimit me kod # **3400**, për procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë e ulët drejtuese, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Tatimeve Indirekte”, në Drejtorinë e Harmonizimit Fiskal, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kategoria III-a, dhe arkivimin e çështjes, pasi veprimet e njësisë përgjegjëse gjenden të kryera në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.
2. Të njoftohet për këtë vendim Ministrina e Financave dhe Ekonomisë, njësisia përgjegjëse (DAP) dhe konkurrentja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha